



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.11

Prishtinë, më 15.04.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Mungoi: Jelena Bontiç.

Pjesëmarrës i ftuar: Arsim Bajrami, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Azem Guri MASHT-Këshilltarë, Osman Buleshkaj MASHT- Këshilltarë, Kushtrim Shkodra MASHT-Këshilltarë, Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Petrit Hysaj-OSBE-së.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.04.2015;
3. Diskutim lidhur me monitorimin e Ligjeve;
4. Diskutim lidhur me vizitën e Komisionit nga Kuvendi i Shqipërisë;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u plotësua me këtë pikë:

5. Raportim i Ministrit të MASHT lidhur Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore dhe inspektimin special rreth diplomave false në Pejë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 08.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 08.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me monitorimin e Ligjeve

Nait Hasani, tha se Komisioni në Planin e Punës për vitin 2015, ka paraparë monitorimin e pesë ligjeve, ndërsa mbetet të funksionalizohen Grupet Punuese, një nga anëtarët e Komisionit duhet të jetë udhëheqës i grupit për monitorim.

Bekim Haxhiu, propozoi që të ketë një vendim të Komisionit për monitorimin e ligjeve në mënyrë që të Grupet punuese të fillojnë punën dhe në fillim të shtatorit të kemi raportin për monitorim të këtyre ligjeve.

Shukrije Bytyqi, propozoi që të zgjedhën kryesuesit për monitorim të ligjeve kurse anëtarë të jenë të gjithë.

Pas debatit, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Ismajl Kurteshi kryesues, Nait Hasani, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, dhe Shukrije Bytyqi anëtarë;*
- 3. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim.*

Komisioni pas diskutimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Diasporën dhe Mërgatën;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Salih Morina kryesues, Nait Hasani, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi anëtarë;*
- 3. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim ne Komision.*

Komisioni pas diskutimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport dhe Ligjit 2003/24 për Sport nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2003/24 për Sport dhe Ligjit 2003/24 për Sport;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Bekim Haxhiu kryesues, Jelena Bontic, Shpejtim Bulliqi dhe Shukrije Bytyqi anëtarë;*
- 3. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim.*

Komisioni pas diskutimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional;*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Nait Hasani kryesues, Shpejtim Bulliqi dhe Shukrije Bytyqi anëtarë;*
- 3. Secili anëtarë i Komisionit sipas interesimit mund t'i bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij;*
- 4. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim.*

4. Diskutim lidhur me vizitën e Komisionit nga Kuvendi i Shqipërisë

Nait Hasani, tha se Komisioni homolog nga Kuvendi i Shqipërisë do të mbërrij të enjten në mbrëmje, vizita do të zgjas deri të shtunën dhe çështjet të cilat do të diskutohen do jenë Marrëveshjet në Arsim dhe Kulturë.

Bekim Haxhiu, pyeti se a është zgjedhur shkolla Dardania për tu vizituar si shkolla më e mirë dhe pse nuk është përcaktuar që të vizitohet Instituti i Historisë në vend të Institutit Albanologjik.

Nait Hasani, tha se agenda lidhur me programin e vizitës është përgatitur në bashkëpunim me Komisionin homolog, ndërsa shkolla Dardania është përzgjedhur nga se konsiderohet nder shkollat më të vjetra në Prishtinë, kurse vizita në Institutin Albanologjik është planifikuar me kërkesën e Komisionit homolog.

5. Raportim i Ministrit të MASHT lidhur Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore dhe inspektimin special rreth diplomave false në Pejë

Nait Hasani, lidhur me rastin e diplomave të Pejës, tha se pret që në formë zyrtare t'i ketë emrat e atyre që janë regjistruar në mënyrë jo të rregullt ndërsa për çështjen e diplomave në Gjakovë, tha se ka neglizhencë nga Gjykata e cila e ka bërë parashkrimin e lëndës.

Ismajl Kurteshi, kërkoi që të gjitha dokumentet që i posedon Ministria ti shpërndahen në formë të shkruar anëtarëve të Komisionit dhe pastaj bazuar në dokumente të marrim qëndrime gjatë diskutimeve.

Shukrije Bytyqi, mbështeti kërkesën për tu njoftuar me dokumentacionin, në mënyrë që të mos akuzohen Komunitetet që kanë mësime me diploma false nëse nuk i kanë.

Bekim Haxhiu, tha se për të gjitha këto dyshime që janë të ngritura në opinion dhe në Komision është më mirë të diskutohet kur ti kemi materialet, që të flasim me argumente të shkruara.

Arsim Bajrami – Ministër i MASHT, lidhur me projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore tha se është përkrahur reforma e kalimit nga pragu i kalueshmërisë në pragu të arritshmërisë dhe lidhur me këtë nuk do të lejojmë uljen e standardit të cilësisë në arsimin parauniversitar. Ai shtoi se Ministria do të jetë në dispozicion gjatë procesit të amendamentimit të projektligjit të Maturës për të ofruar sqarime dhe për të dhënë komente. Në vazhdim njoftoi Komisionin me fillimin e procesit të vlerësimit ndërkombëtarë PISA 2015, që për herë të parë organizohet në Kosovë. Lidhur me problemin e diplomave false në Pejë, tha se Ministria ka urdhëruar inspektim special dhe ka konstatuar se bëhet fjalë për 522 regjistrime të parregullta, nga këto regjistrime 190 kanë diplomuar, 319 raste nuk kanë diplomuar asnjëherë, ndërsa 14 kanë diplomuar në mënyrë të parregullta që konsiderohen të jenë raste me të renda. Tha se ka vërejtur që gjyqësori ka neglizhuar plotësisht rastin, ndërsa sa i përket rastit të Gjakovës, tha se kemi filluar inspektimin.

Nait Hasani, në vijim tha se në mbledhjen e kaluar Komisioni e ka shqyrtuar para miratimit në parim projektligjin për Provimin e Maturës Shtetërore dhe ka pasur shumë vërejtje.

Shpejtim Bulliqi, tha se vërejtjet e tij në projektligjin e Maturës i ka paraqitur edhe në mbledhjen e kaluar, me këtë rast përmendi vërejtjet në nenin 17 që ka të bëjë me përshkallëzimin e përqindjes me rastin e pranimin të studentëve. Ai propozon që kjo përqindje të rishikohet si dhe të fshihet paragrafi 4 i nenit 17 që ka të bëjë me regjistrimet e studentëve para fillimit të zbatimit të Kornizës së Kurrikulës në disa njësi akademike.

Teuta Haxhiu, tha se vërejtjet në projektligjin e maturës i ka në detaje për secilin nen veç e veç dhe ato do të prezantohet gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit. Në vazhdim pyeti se si do të bëhen hetimet e diplomave në Gjakovë, me një numër kaq të vogël të inspektorëve.

Arsim Bajrami, tha se kemi 56 inspektor dhe jemi duke punuar që të rritet numri i tyre në 100, në mënyrë që secila Komunë të ketë inspektor dhe në raste konkret do të dërgojmë inspektor të pavarur.

Bekim Haxhiu, tha se Ministria duhet të punojë rreth procesit të digjitalizimit të testit të Maturës sepse kjo do të ishte mundësia më e mirë për vlerësim real. Sa i përket rastit të diplomave të Pejës tha se mbështet nismën që inspektorati të profesionalizohet dhe të profilizohet.

Shukrije Bytyqi, tha se do të vazhdojmë të punojmë në projektligjin e Provimit të Maturës që ti përmirësojmë gabimet dhe shtoi se digjitalizimi i maturës do të ishte i mirëseardhur sepse do të ishte vlerësim më real, ndërsa theksoj se është e domosdoshme rritja e numrit të inspektorëve. Rreth konkursit të shpallur në komunën e Malishevës kërkoi që të njoftohet me procesin e punësimit dhe shtoi se ky konkurs ka qenë i kundërligjshëm sepse është shpallur para përfundimit të vitit shkollor.

Ismajl Kurteshi, tha se në projektligjin e propozuar ka çështje të cilat i relativizojnë nenet e caktuara dhe vjen në shprehje subjektivizmi, si në nenin 19, parapari 2 që ka të bëjë me vërtetimin e identitetit të kandidatëve dhe nenin 29 paragrafi 1 dhe 2 që ka të bëjë me sanksionet ndaj rasteve që zbulojnë ndonjë sekret të testit të maturës.

Salih Morina, tha se është në interes të shoqërisë në përgjithësi që të angazhohemi të gjithë në këtë projektligj, ta bëjmë në një afat kohor më të shkurtër por sa më mirë.

Nait Hasani, tha se duke pasuar parasysht rendësin e miratimit të këtij projektligji, si dhe afatet kohore për organizimin e testit të maturës do të propozojmë që ky projektligj të radhitet për shqyrtim të parë në seancën plenare.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Nait Hasani